

**LLOJET E LEJEVE TË ZHVILLIMIT/NDËRTIMIT PËR TË CILAT ËSHTË
PËRGJEGJËSE NJËSIA E QEVERISJES VENDORE.**

Referuar **Ligjit 107/2014 datë 01.10.2014** “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 29, përcakton se, *Kryetari i bashkisë është përgjegjës për vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë.*

Në zbatim të **VKM Nr. 408, Datë 13.5.2015**, “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar me **VKM nr. 271, datë 06.04.2016**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”, **VKM nr. 231, datë 21.03.2017**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”, dhe **VKM Nr. 355, datë 19.04.2017**, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar”, Llojet e lejeve të zhvillimit/ndërtimit, për vendimmarrjen e të cilave është përgjegjës Kryetari i Bashkisë, por pa u kufizuar në to, janë:

1- Leje zhvillimi/ndërtimi për ndërtime të reja, sipas funksionit:

- I. Banim;*
- II. Infrastrukturë;*
- III. Struktura Publike;*
- IV. Turizëm;*
- V. Shërbime;*
- VI. Industri;*
- VII. Bujqësi;*
- VIII. Blegtori;*
- IX. Objektet mbi 9 kate.*

2- Shtesa në ndërtime ekzistuese;

3- Rikonstruksione;

4- Ndryshimi i destinacionit;

5- Prishje ndërtimi.